

VENDIM
Nr. 749, datë 26.10.2016

**PËR RISHPËRNDARJE FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ligjit nr. 77/2016, datë 22.7.2016, “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës, me objekt projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e portit të Karpenit, zonës mbështetëse të portit dhe asaj ekonomike, ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë “Star Bridge Port Developments Limited””, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, bëhet rishpërndarje e fondit, ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Planifikim, menaxhim, administrim” shtohet fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh, përkatësisht: 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë në zërin “Shpenzime korrente” dhe 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë në zërin “Shpenzime kapitale të brendshme”. Fondi prej 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekësh të përdoret për mbulimin e shpenzimeve të konsulentëve të huaj që do të bëjnë studimin dhe vlerësimin ligjor e financiar për projektin “Projektimi, ndërtimi, operimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i portit të Karpenit, zonës mbështetëse të portit dhe asaj ekonomike”.

b) Në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik” pakësohet fondi prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”.

c) Në programin “Zhvillimi i turizmit” pakësohet fondi prej 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime kapitale të brendshme”.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi